



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

## MEMORANDUM SHPJEGUES

### PËR

## PROJEKT UDHËZIMIN ADMINISTRATIV NR. X/2023 PËR PROCEDURAT PËR KOMPENSIMIN E MBROJTËSVE ME SHPENZIME PUBLIKE

1. Qëllimi i hartimit të aktit normative

Ky udhëzim administrativ ka për qëllim krijimin e kriterëve dhe procedurave për caktimin e avokatit mbrojtës me shpenzime publike në çështjet penale si dhe lartësinë e kompensimit, në të gjitha gjykatat e Republikë së Kosovës.

Tutje, ky udhëzim administrativ përcakton kompensimin dhe lartësinë për shërbime të avokatit mbrojtës duke përfshirë edhe lartësinë e kompensimit për shqyrtimin e shkresave, si dhe lartësinë e kompensimit për përpilimin e mjeteve juridike.

	<p>Projekt Udhëzimi administrativ përcakton edhe zyrtarët kryesorë të cilët do të merren me zbatimin e këtij e tij.</p>
<p>2. Arsyetimi i aktit normative</p>	<p>Përmes këtij udhëzimi administrativ synohet që të bëhet kompensimi i avokatit mbrojtës me shpenzime publike.</p> <p>Arsyeja e hartimit të këtij drafti është përcaktimi i të gjitha formave të kompensimit për shërbimet e avokatit mbrojtës me shpenzime publike.</p> <p>Risi në projekt Udhëzimit Administrativ nr. X/2023 për Procedurat për Kompensimin e Mbrojtësve me Shpenzime Publike është se përmes këtij drafti janë përcaktuar kritere dhe lartësia e kompensimit për avokatëve mbrojtës për vizitat e të pandehurit në paraburgim apo në entin shëndetësor, kritere këto të cilat nuk kanë janë parapara me udhëzimin administrativ aktualisht në fuqi.</p> <p>Ky udhëzim administrativ është i nevojshëm për disa arsye të rëndësishme.</p> <p>Së pari, synon përcaktimin e procedurave dhe kritereve të qarta dhe të sakta për kompensimin e avokatëve mbrojtës me shpenzime publike, duke i përcaktuar edhe</p>

	<p>zyrtarët kryesorë të cilët do të merren me zbatimin e këtij udhëzimi administrativ.</p> <p>Së dyti, përcakton edhe rastet e lartësisë së kompensimit për avokat mbrojtës me shpenzime publike në rastet kur seancat gjyqësore zgjatë më shumë se një (1) orë, si dhe rastet e kompensimit kur seancat gjyqësore shtyhen apo nuk mbahen pa fajin e avokatit mbrojtës.</p>
<p>3. Kohëzgjatja e konsultimit publik</p>	<p>Përmes procesit të konsultimeve me publikun, synohet transparenca dhe ofrohet mundësia e pjesëmarrjes së publikut dhe palëve të interesuara në procesin e hartimit të Draftit udhëzimit administrativ nr. X/2023 për Procedurat për Kompensimin e Mbrojtësve me Shpenzime.</p> <p>Këshilli fton të gjithë profesionistët e interesuar që të paraqesin komentet apo sugjerimet e tyre, për përmirësimin e draftit të kësaj rregullore.</p> <p><b>Kohëzgjatja e konsultimit publik është pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike, përkatësisht deri me 4 tetor 2023.</b></p>
<p>4. Informatat në lidhje me personin kontaktues për konsultim publik</p>	<p>Të gjithë pjesëmarrësit e publikut dhe palët e interesuara mund t'i japin komentet dhe sugjerimet e tyre brenda afatit të përcaktuar</p>

për konsultim publik për këtë draft të udhëzimit administrativ, përmes postës elektronike në këtë e-mail adresë:

[kgjk@rks-gov.net](mailto:kgjk@rks-gov.net)